

## Fakte mbi Aktivitetin Filantropik

Mars 2016


Partnerët Shqipëri, si pjesë e misionit të saj në mbështetje të sektorit jo-fitimprurës në Shqipëri dhe forcimit të bashkëpunimit ndërsektorial, po punon për zhvillimin e filantropisë në Shqipëri. Për këtë janë kryer një seri studimesh mbi nivelin e zhvillimit të filantropisë në vend (**Sipërmarrja dhe Filantropia-Raport i Studimit, Një Vështrim Historik mbi Zhvillimin e Filantropisë në Shqipëri, Raporti i monitorimit të aktivitetit filantropik në Shqipëri gjatë vitit 2015**), një seri ndërhyrjesh afatgjata që synojnë evidentimin e këtij aktiviteti nga ana e sektorit të biznesit (**Çmimi i Filantropisë**), si dhe krijimi i platformave që sjellin realisht më pranë biznesin në mbështetje të

çështjeve sociale (**Konkursi i Ideve të Gjelbërta**).


Për të dytin vit radhazi Partnerët Shqipëri do të kryejë monitorimin e aktivitetit filantropik në Shqipëri nëpërmjet hulumtimit të medias, përfshi edhe ato sociale si dhe burimeve të informacionit nga institucionet publike dhe jo-publike. Hulumtimi kryhet mbi baza ditore dhe gjetjet paraqesin çështjet e mbështetura, natyrën dhe vlerën e dhurimeve, mbulimin gjeografik si dhe natyrën e dhuruesve. Ato vijnë në formën e informacionit të përmbledhur mujor që synon të ndihmojë në kuptimin dhe evidentimin e këtij aktiviteti.

**Gjatë muajit Mars 2016 vlera e dhurimit të raportuar në nivel vendi është 21,551,360 Lekë, sipas të dhënave të mëposhtme.**


**Vlera e Dhurimeve sipas Natyrës**




**Vlera e dhurimit sipas Natyrës së Dhuruesve**




### Kanalet e Dhurimit




### Fushat e Dhurimit




### Natyra e Dhuruesit




### Numri i Dhurimeve sipas Natyrës



### Shtirirja Gjeografike e Dhuruesve



### Shtirirja Gjeografike e Përfituesve



Për muajin mars të gjitha dhurimet kanë shkuar për **Publikun e gjerë**.

Në krahasim me muajin mars të vitit 2015 vihet re një ulje e vlerës së dhurimit prej 3,475,682 Lekë ose 14%. Ndërsa për tre-mujorin e parë të 2016, muaj mars renditet i pari në krahasim me dy muajt paraardhës me një rritje të vlerës së dhurimit prej 19,419,555 Lekë ose 51% nga muaj janar dhe 18,652,940 Lekë ose 49% nga muaj shkurt.